

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

ZGJIDHJET

P4

FLETË PROVIMI

Data 08.02.2020

PËRMBAJTJA :

Pjesa	Maksimumi i dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
C. Pyetjet problemore		
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	10	
4. Problemi 4	8	
5. Problemi 5	5	
6. Problemi 6	7	
Total	100	

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë

Nga 2 pikë secila

1. Noar Krasniqi në muajin Dhjetor 2019 ka pasur rrogën Bruto (primare) prej 650.00 Euro. Në Janar të vitit 2020, menaxhmenti vendosi që paga e Noarit të zvogëlohet për Neto vlerë prej 50.00 Euro për shkak të performancës së dobët. Sa do të jetë paga Bruto në Janar të vitit 2020 për Noarin?
 - a) 591.92 Euro;
 - b) 597.37 Euro;
 - c) 600.00 Euro;
 - d) 650.00 Euro.
2. Fature në vlerë prej 702.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkulur gabimisht me Tvsh prej 8% duhet të korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë është kthyer edhe një sasi e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar në faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 150.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
 - a) 500.00 Euro;
 - b) 552.00 Euro;
 - c) 590.00 Euro;
 - d) 650.00 Euro.
3. Kompania "Klerti", në Tetor 2019 ka pranuar një notë debitore të lëshuar nga kompania "Aroni" për blerjet të cilat i ka bërë "Klerti" para dy muajve nga kjo e fundit. Nota debitore e pranuar nga "Klerti" është në vlerë 2,345.67+Tvsh 18%. Për kompaninë "Aroni" kjo notë ka ndikim që:
 - a) rrit Tvsh e zbritshme;
 - b) rrit Tvsh e llogaritur;
 - c) zvogëlon Tvsh e zbritshme;
 - d) zvogëlon Tvsh e llogaritur.
4. Biznesi LURA shpk veprimtaria afariste e të cilit është tregtia me pakicë, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me TVSH, si duhet të deklarojë tatimin e të hyrave nga qiraja në baza tremujore ky biznes?
 - a) Normë standarde 18% apo të reduktuar 8%;
 - b) Shërbyese me 9%;
 - c) Tregtare me 3%;
 - d) Shërbyese dhe tregtare me 10%;
 - e) Asnjëra më lartë.

5. Kompania "Riani" shpk importon një kamion nga Gjermania. Vlera e faturuar nga kompania gjermane është 8,200 Euro. Kosto e transportit nga Gjermania në Kosovë është 800 Euro. Dogana e Kosovës me rastin e importit të kësaj blerje investive ka bërë rivlerësim të asetit për të cilën kanë vendosur bazën e re doganore sipas katalogëve përkatës në vlerë prej 10,280 Euro. Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "Riani" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa duhet të jetë kosto e blerjes investive që do të vendoset në librat e kompanisë "Riani"?
- a) 9,900.00 Euro;
 - b) 10,108.00 Euro;**
 - c) 11,308.00 Euro;
 - d) 12,188.00 Euro.
6. Qiradhënësi "Flandra" shpk, një biznes tregtar, lëshon faturën për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "Blendi" shpk. Vlera e faturës është 1,770.00 përfshirë Tvsh. Sa duhet të ndalë dhe paguajë tatim në burim si dhe sa do ti **pagujë** Qiramarrësi "Blendi" shpk për këtë faturë tatim ATK-së dhe Qiradhënësit Flandra. Fatura është subjekt i tatimit të qirasë sipas normës së aplikueshme të ligjit në Kosovë.
- a) 135.00 Euro Tatim dhe 1,500.00 Euro pagesë Qiradhënësit;
 - b) 135.00 Euro Tatim dhe 1,635.00 Euro pagesë Qiradhënësit;**
 - c) 159.30 Euro Tatim dhe 1,770.00 Euro pagesë Qiradhënësit;
 - d) 159.30 Euro Tatim dhe 1,929.30 Euro pagesë Qiradhënësit.
7. Bazuar në ligjin Nr. 06/L-105 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues që të tatimohet në baza reale dhe që ai tatimpagues të konsiderohet person i tatueshëm për Tvsh, (përveq nëse regjistrohet vullnetarisht) duhet të arrijë përkatësisht të kalojë pragun e të ardhurave vjetore prej :
- a) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - b) 50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - c) 50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - d) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;**

8. Biznesi "JONI", person i tatueshëm, me seli në Kosovë ofron shërbime vlerësimi të një prone në Lipjan (vlerësim të përcaktimit të vlerës së tregut), në vlerë të tatueshme prej 345.67 Euro për kompaninë "Blendd" që e ka selinë në Belgjikë. Për këtë shërbim, kompania kosovare duhet të lëshojë faturën në total:
- a) 345.67 Euro;
 - b) 373.32 Euro;
 - c) 407.89 Euro**
 - d) 345.67 Euro me Ngarkesë të kundërt;
 - e) Asnjëra më lartë.
9. Kompania "VESA" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën me produkte të përziera, me normë standarde dhe normë të reduktuar. Vlera e Tvsh-së në këtë faturë ka qenë 225.00 euro. 40% e kësaj vlere ka qenë me normë standarde dhe pjesa tjetër me normë të reduktuar. Sa është vlera totale e faturës së lëshuar përfshirë Tvsh?
- a) 450.00 Euro;
 - b) 590.00 Euro;
 - c) 2,187.50 Euro;
 - d) 2,412.50 Euro;**
10. Kompania "ABC" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 456.00 (përfshirë Tvsh me normë standarde) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 18% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e të hyrave pas zbritjes që do të paraqiten në libra si vlerë e tatueshme për furnizimin e bërë?
- a) 306.61 Euro;
 - b) 316.88 Euro;**
 - c) 386.44 Euro;
 - d) 456.00 Euro;

Pjesa A. Pyetjet “E saktë/ E pasaktë”

Nga 1 pikë secila

1. Me rastin e regjistrimit fillestar, Shoqërisë Tregtare ose subjekti tjetër i përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji i lëshohet Numri Unik Identifikues i cili shërben njëkohësisht si numër për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për qëllime të regjistrimit dhe jo për qëllime tatimore, si dhe për qëllime të tjera të përcaktuara në akte nënligjore.

E saktë

E pasaktë

2. Zyra e Regjistrimit duhet të ruajë së paku 6 vite të gjitha shënimet dhe dokumentet, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara.

E saktë

E pasaktë

3. Mospagesa e detyrimit të tatimit në kohën e paraparë me ligjet tatimore, bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do të paguajë një interes prej 0.56% në muaj apo pjesë të muajit.

E saktë

E pasaktë

4. Gjatë ose pas regjistrimit në ARBK, një Shoqëri Tregtare, duke përfshirë Bizneset Individuale mund të dorëzojnë aplikacion në ARBK për shfrytëzimin e një Emri Tregtar që është i ndryshëm nga Emri Zyrtar i Shoqërisë Tregtare si dhe Shoqëritë Tregtare mund të regjistrojnë një ose më shumë Emra Tregtarë.

E saktë

E pasaktë

5. Kontributi i një aksionari në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkëmbim me një Aksion, mund të bëhet në të holla; pronë tjetër, materiale ose jo-materiale; me punë ose shërbime të ekzekutuara.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i pazbritshëm/

E saktë

E pasaktë

7. Bazuar në Ligjin nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, perkatësisht nenin **10 Auditimi i pasqyrave financiare**, të gjitha auditimet në Kosovë që përfshijnë të gjitha auditimet e kërkuara nga ky Ligj, raporti i auditimit nënshkruhet nga firma ligjore, ku firmoset edhe data e nënshkrimit. Kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nënshkruhet të paktën nga zyrtari/përfaqësuesi ligjor në emër të firmës së auditimit.

E saktë

E pasaktë

8. Bazuar në Ligjin nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të përcaktuara me këtë ligj klasifikohen si mikro-ndërmarrje, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual, sipas kriterëve të mëposhtme:
- 1.1. pasqyra e pozitës financiare;
 - 1.2. qarkullimi neto; dhe
 - 1.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar.

E saktë

E pasaktë

9. Bazuar në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se tre (3) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

10. Tatimpaguesi i cili ka tejkalar qarkullimin bruto vjetor mbi pesëdhjetë mijë Euro (50.000€), si dhe ai i cili ka përzgjedhur vullnetarisht të tatohet në të ardhura reale, është i obliguar që të raportojë të ardhurat dhe të bëjë pagesat si biznes i madh, për periudhën tatimore në të cilën bruto qarkullimi tejkalon pesëdhjetë mijë Euro (50.000€) apo për periudhën kur ka përzgjedhur vullnetarisht të tatohet në të ardhura reale dhe së paku për tri (3) periudha tatimore vijuese.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, që paguan qira, mban dhjetë për qind (10%) të tatimit në të ardhurat bruto, në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 50.000 Euro apo më pak për të zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe të paguaj tatim në fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 31 Janar të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon të regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas ligjit të Tvsh, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për Tvsh nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë Euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas Ligjit të TVSH-së, Notë krediti kuptojmë – dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e TVSH-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me i vogël se obligimi real i TVSH-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit të Tvsh-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të Tvsh-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, periudha tatimore për bizneset individuale që kanë një qarkullim nën 50,000 Euro dhe që nuk janë të regjistruar në fitimin real, është çdo vit.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit të TVSh-se, furnizimet me ujë dhe kripës industriale aplikohet norma e reduktuar (8%).

E saktë

E pasaktë

18. Sipas Ligji të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas dispozitave të ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Fitimet kapitale nënkuptojnë të ardhurën, të cilën tatimpaguesi e realizon përmes shitjes apo formave tjera të tjetërsimit të pasurive kapitale duke përfshirë pasurinë e tundshme, patundshme dhe letrat me vlerë.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

Kompania ABC shpk me seli në Prishtinë kryen disa aktivitete ekonomike tregtare në tërë territorin e Kosovës. Gjatë muajit Nëntor 2019 ka patur këto transaksione:

- i. shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatueshme 60,000 Euro;
- ii. shpenzime për shërbime transportit Prishtinë - Gjilan 6,200 Euro;
- iii. importe nga jashtë (mallra për qëllime tregtimi) në vlerë 24,000 Euro, nga të cilat 60% janë importe me normë standarde dhe pjesa tjetër me normë të reduktuar;
- iv. shpenzimet e derivateve 3,300 Euro; prej tyre 20% e tyre kanë qenë për pajisjen për gjenerim të rrymës-agregat të marrë me qira;
- v. blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të regjistruar në Tvsh 2,200 Euro,
- vi. import nga Zvicra (mjet transportues) i cili nevojitet për shërbime transporti 12,000 Euro,
- vii. blerje e një veture në vlerë prej 30,000 Euro nga një biznes vendor AS ARTI, i cili konsiderohet si veturë luksi, në mënyrë të barabartë e shfrytëzon për qëllime personale dhe për biznes;
- viii. notë kreditore e lëshuar me norme 18% vlera 1,500 Euro shuma e tatueshme;
- ix. notë debitore e pranuar me norme 18% vlera 500 Euro shuma e tatueshme;
- x. shpenzime të rrymes dhe ujit etj të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar prej 750 Euro (shuma e tatueshme).

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 4,200Euro (ngarkesë e kundërt për shërbime).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire Tvsh-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 11/2019 duke marrë parasysh se për biznesi në fjalë në muajin e kaluar Tetor ka pasur obligim për pagesë prej 2,500 Euro.

Zgjidhje:

Ekstrakt i deklaratës mujore Nëntor 2019:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TE TVSH			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	11	2019
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600600600	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	ABC SHPK	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINE, KOSOVE	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Filan Fisteku 044/123123	
Furnizimet Vlera TVSH			
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	60,000	10,800
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	4,200	756
		Kolona [30]	11,556
Blerjet Vlera TVSH			
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	2,200.00	
Importet me normë 18%	Kolona [35]	14,400	2,592
Importet me normë 8%	Kolona [37]	9,600	768
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	13,200	2,376
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [43]	9,500	1,710
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	750.00	60
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	15,000.00	2,700
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	2,000.00	360
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	4,200.00	756
		Kolona [67]	11,322
Kalkulimi Vlera			
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	-	
Balanca kreditore e mbetur $69 = ((67+68)-30)>0$	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues $71 = (69-70)$	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet $72 = (30-67-68)>0$	Kolona [72]	234.00	

Sqarim:

Importet me normë 18% :	$24,000 \times 60\% = 14,400$
Importet me normë 8% :	$24,000 \times 40\% = 9,600$
Importet investive me normë 18% :	$12,000 + \text{dogana } 10\% = 13,200$
Blerjet vendore me 18% :	$6,200 + 3,300 = 9,500$
Blerjet investive vendore me normë 18% :	$30,000 \times 50\% = 15,000$
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18% :	$1500 + 500 = 2,000.$

Problemi 2**15 pikë**

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues i kompanisë tregtare BLENDI Sh.p.k me saldo të datës 31. 12. 2019.

Nr.	Përshkrimi i llogarisë	Shënim	Debi	Kredi
1	Banka		36,054	
2	Arka		4,520	
3	Llogaritë e arkëtueshme		310,000	
4	Stoku		230,000	
5	Makineritë		260,500	
6	Zhvlerësimi i akumuluar			111,439
7	Pajisjet		25,492	
8	Zhvlerësimi i akumuluar			14,549
9	Llogaritë e pagueshme			15,400
10	Tatimi në fitim		9,300	
11	Akrualet			3,750
12	Kapitali			35,000
13	Obligimet për kontribute pensionale			1,900
14	Obligimet për tatim në paga			1,210
15	Obligimet për paga			21,090
16	TVSH			11,662
17	Fitimi i mbajtur			5,500
18	Të ardhurat nga shitja			2,945,766
19	KMSH		1,485,000	
20	Shpenzimet e sigurimit		12,300	
21	Shpenzimet e komunikimit		7,200	
22	Uji		1,500	
23	Rryma		9,300	
24	Pensionet		26,400	
25	Shpenzimet bankare		1,700	
26	Zhvlerësimi		60,800	
27	Provizionet		10,200	
28	Trajnime të stafit		3,200	
29	Donacion		17,700	
30	Shpenzimet e karburantit		19,100	
31	Shpenzimet e zyres		18,500	
32	Pagat		525,600	
33	Shpenzimet profesionale		8,100	
34	Qiraja bruto		23,400	
35	Shpenzimet e penaliteteve, interesit dhe vonesave në pagesa për ATK		1,900	
36	Shpenzimet e përfaqësimit		65,000	
37	Të ardhurat tjera			5,500
	TOTAL		3,172,766	3,172,766

Informacion shitesë:

1. Shpenzimet e karburantit: 20% e vlerës janë fatura të parregullta;
2. Asetet në bilancin vërtetues janë zhvlerësuar sipas politikave të kompanisë dhe rrjedhimisht ka rezultuar shpenzimi përkatës në bilancin vërtetues. Makineritë i takojnë grupit të III-të sipas tatimeve ndërsa Pajisjet i takojnë grupit të II-të. Të gjitha asetet janë blerë para viti 2019;
3. 80% e shpenzimeve të donacionit janë të dokumentuara;
4. Provizioni nuk ka të bëjë me ndonjë llogari të veçantë të arkëtushmeve por janë politikë e kompanisë për ndarje të lejimeve në llogari të arkëtueshme;
5. 30% e shpenzimeve të përfaqësimit nuk janë të mbuluara me dokumentacion përkatës.
6. Qiraja për muajin Nëntor dhe Dhjetor do të paguhet në Maj 2020; po në të njëjtin Muaj do të ndalet tatimi në burim. Nuk ka pas ndryshim të qirasë nga Janari deri në Dhjetor.
7. Pagat e stafit për muajin Dhjetor do të paguhet në Shkurt 2020. Nuk ka pas ndryshim të pagave nga Janari deri në Dhjetor.
8. Të ardhurat tjera - kanë të bëjnë me shitjen e një makinerie i cili në fund të vitit 2018 është zhvlerësuar i tëri, vlera kushtuese e kësaj makinerie ka qenë 8,200 Euro;
9. Të rishikohet çdo shpenzim i limituar sipas Ligjit "Për tatimi në të ardhurat e korporatave"

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë BLENDI Sh.p.k. me 31.12.2019.

Zgjidhje

Te ardhurat	2,945,766
-KMSH	1,485,000
Fitimi bruto	1,460,766
-Shpenzimet totale (shp. prej #20-#36)	811,900
+Te ardhurat tjera (fitimi kapital)	5,500
Fitimi kontabel	654,366
Rregullimet:	
+Shpenzimet e karburantit	3,820
+Zhvleresimi	29,652
+Donacioni	17,700
+Provizionet per LLA	10,200
+Shpenzimet e përfaqësimit	35,543
+Qiraja	3,900
Fitimi para donacionit	757,81
-Donacioni	14,160
Fitimi para tatimit	742,921
-Tatimi 10%	74,292

(1*) Shpenzimet e karburantit: $19,100 \times 20\% = 3,820$ shpenzim i pazbritshëm;

		%	Zh. Tatimor	Zh. Kontabël	Diferenca
(2*) Makineritë	260,500	10	26,050		
Pajisjet	25,492	20	5,098		
Total			31,148	60,800	29,652 shp. i pazbritshëm;

(4*) Provizionet për llogaritë e arkëtushme nuk janë shpenzime të periudhës për qëllime tatimore;

(5*) Gjodat nuk pranohen si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore;

(6*) Të ardhurat $2,945,766 \times 1\% = 29,457$ shpenzimet përfaqësimit të lejuar sipas ligjit. Të ndodhura $65,000 - 29,457 = 35,543$ shpenzimet e përfaqësimit të papranuara për qëllimet tatimore. Sqarim: 30% e shpenzimeve të përfaqësimit nuk janë mbuluar me dokumentacion por nuk kanë efekt pasi që vlera e tyre është 19,500 dhe gjendet brenda vlerës prej 35,543.

(7*) Qiraja $23,400/12 = 1,950 \times 2 = 3,900$ shpenzim i pazbritshëm i periudhës, pasi që ligji e kufizon çdo shpenzim që lidhet me tatimin në burim që nuk paguhet deri me datë 31 Mars të vitit në vijim nuk do të jetë shpenzim i kësaj periudhe;

(8*) Pagat janë paguar brenda Marsit të vitit në vijim dhe do të jenë shpenzim i pranuar i periudhës;

(9*) Shitja e aseteve njihet e ardhur e vitit sipas vlerës së shitjes pasi VNL ka qenë zero (0) dhe rrjedhimisht vlera e shitjes njihet si fitim kapital;

(3*) Fitimi para donacionit $757,081 \times 10\% = 75,708$ donacion i lejuar si shpenzim sipas ligji.

Donacioni i ndodhur është 17,700 dhe është brenda limitit të lejuar por për shkak se vetëm 80% e shpenzimit është i dokumentuar do të pranohet vetëm kjo pjesë si shpenzim ($17,700 \times 80\% = 14,160$).

Problemi 3**10 pikë**

Kompania FLANDRA shpk më datë 31.12.2019 kishte ketë shpenzim të zhvlerësimit sipas kontabilitetit:

Grupi I -	11,500
Grupi II -	8,500
Grupi III -	15,000

Për grupin e parë kompania kishte një politikë të zhvlerësimit 7% në vit, për grupin e dytë 10%, për grupin e tretë 8%. Kompania me 1 gusht të vitit 2019 kishte blerë një aset të grupit të tretë në vlerë prej 45,000 Euro (zhvlerësuar sipas muajit për qëllime kontabël). Të gjitha asetet tjera janë blerë gjatë vitit 2018.

Kërkohet:

a) Llogaritni ndryshimin e zhvlerësimit në mes të kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të tatimeve sipas grupeve?

Zgjidhje:

Grupi I

Sipas politikave të kontabilitetit:	$164,285.71 \times 7\% = 11,500.00$
Sipas ligjeve tatimore:	$164,285.71 \times 5\% = 8,214.28$
Zvogëlim e zhvlerësimit	3,285.72

Sqarim: $11,500/7\% = 164,285.71$

Grupi II

Sipas politikave të kontabilitetit:	$85,000 \times 10\% = 8,500.00$
Sipas ligjeve tatimore:	$85,000 \times 20\% = 17,000.00$
Rritje e zhvlerësimit	8,500.00

Sqarim: $8,500/10\% = 85,000$

Grupi III

Sipas politikave të kontabilitetit aseti i ri	$(45,000 \times 8\% = 3,600/12 \times 5) = 1,500$
Sipas politikave të kontabilitetit të tjera	$168,750 \times 8\% = 13,500$
Total për Kontabiliteti	15,000
Tatimet aseti i ri	$45,000 \times 10\% /$ 2,250
Tatimet	$168,750 \times 10\% = 16,875$
Totali për Tatime	16,125
Rritja e zhvlerësimit	1,125

Sqarim: $15,000 - 1,500 = 13,500$
 $13,500/8\% = 168,750$

Problemi 4

8 pikë

Kompania NOAR shpk ka të punësuar 3 persona. Pagat e të punësuarve për muajin Tetor 2018 janë si me poshtë:

1. Menaxherin e shitjes me pagë mujore neto 900.00 Euro (pagë me punë primare);
2. Zyrtarin financiar me pagë mujore bruto 250.00 Euro (pagë sekondare);
3. Rojen e natës me pagë mujore bruto 300,00 Euro (pensionist).

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga (Tatimi) dhe detyrimin e kontributeve pensionale (KP) për muajin Tetor 2019 të këtyre të punësuarve (Kujdes për pagat janë **neto/bruto**).

Zgjidhje:

1. Menaxheri: paga neto = 900.00

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla Tatimi e tat.		Paga Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0.00	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.80	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00	427.20
4.(3*)	525.33	10%	52.53	472.80 (3*)	900.00
TOTAL	975.33		75.33	900.00	

Llogaritjet:

(1*) diferenca e pagës nga 80 - 250 = 170

(2*) diferenca e pagës nga 250 - 450 = 200

(3*) diferenca e pagës neto 80+163.20 +184= 427.20

Paga neto e menaxherit: 900 - 427.20= 472.80/90%= 525.33

KP:

Paga bruto: 975.33/95%= 1,026.66

KP = 1,026.66 x 5% = 51.33 +51.33 = 102.66

2. Zyrtari financiar: paga bruto sekondare = 250.00 Euro

KP=250x5% = 12.50 +12.50 = 25.00

Tatimi = (250.00-12.50)x10% =23.75

3. Roja e natës: paga bruto (pensionist) = 300.00 Euro

KP= 0.00

Tatimi = 300.00x10% =30.00

Problemi 5

5 pikë

Noar shpk ka pranuar akt vendimin e raportit final të kontrollës nga ATK me datë 19 Mars 2017 për periudhën tatimore 10/2015 të TVSH-së. Aktvendim e raportit final rezulton me tatim shtesë në shumë prej 5,000 Euro.

Kompani Noar shpk për këtë periudhe kishte deklaruar dhe paguar me datë 21.11.2015 obligimin tatimore prej 12,200 Euro.

Kërkohet:

Sa janë gjordat dhe interesi për tatimin e nën deklaruar të dal nga kontrolli i ATK-së që kompania duhet paguar duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje:

1* Gjorda për nën deklarim tatimor	$5,000 \times 25\% = 1,250$
2* Gjorda për mos deklarim në kohë (1 muaj)	$5,000 \times 5\% = 250$
3* Gjorda për mos pagese në kohë (12 muaj)	$5,000 \times 12\% = 600$
4* Interesi (17 muaj $\times 0.65\%$)	$5,000 \times 11.05\% = 552.50$
TOTALI	2,652.50

1* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat ATK-së: nëse nëndeclarimi është më i lartë se 10 % ndëshkimi është 25% i shumës se nëndeclaruar.

2*Neni 51 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-së: për mos deklarim të tatimit në kohë ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 1 muaj vonesë.

3*Neni 51 pika 2 i ligjit për procedurat ATK-së: për mos pagesë të tatimit në kohë ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 12 muaj.

4 * Neni 28 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-së: deri në ditën e pagesës së tatimit llogaritet interes 0.65% në muaj. Në rastin konkret ne kemi të bëjmë me 17 muaj mos pagese të tatimit.

Problemi 6

7 pikë

Kompania JONI BI në fillim të vitit 2020 (Janar) ka lidhur marrëveshje me 2 biznese për marrjen me qira të dy (2) lokaleve për vitin 2020 dhe 2021.

Lokali i parë ka qene 400m² ndërsa lokali i dytë ka qenë 600m² zyre dhe 1,600m² depo/magazinë.

- Për lokalin e parë marrëveshja është: 6.00 Euro bruto/m²/muaj dhe me pagesë në baza 6 mujore në avanc/parapagim.
- Për lokalin e dytë marrëveshja është: 4.50 Euro neto/m²/muaj për zyre dhe 2.50 Euro neto/m²/muaj për pjesën e depos/magazinë dhe me pagesë në baza mujore në avanc/parapagim.

Gjatë muajit Janar janë paguar qiratë për pronat e marra me qira sipas kushteve të përcaktuara në kontratë duke aplikuar legjislacionin tatimor në Kosovë.

Kërkohet:

Të kalkulohet tatimi i mbajtur në burim (pjesa e qirasë) për muajin Janar 2020 për kompaninë JONI BI?

Zgjidhje:

- **Lokali 1:**

6.00 Euro/m² x 400m² x 6 muaj = 14,400 Euro bruto (bazë për kalkulim)

- **Lokali 2:**

Pjesa e zyreve: 4.50 Euro NETO/m² x 400m² =1,800 Euro Neto=> 1,978.02 Euro bruto (bazë për kalkulim)

Pjesa e depos: 2.50 Euro NETO/m² x 1,600m² =4,000 Euro Neto=> 4,395.60 Euro bruto (bazë për kalkulim)

Total bruto: Lokali 1+ Lokali 2 (zyre + depo)= 14,400+1,978.02+4,395.60= 20,773.62

Tatimi i mbajtur në burim : 20,773.62 x 9% = 1,869.62